

AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“OSOJA- ENERGY” sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare’ dhe atij nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin tone te lire, ne:

- 1. Shoqeria “ADNAN QYLAFI” Person Fizik me TVSH me numer NIPT K84508002F,**
- perfaqshuar nga administratori i saj zoti Adnan Qylafi i biri i Fatmir shtetas shqiptar, lindur me 01.06.1966 ne Korce dhe banues ne Melcan , Korce, me leter njoftim nr. 028738414 dhe

- 2. Shoqeria “Vashtemia” shpk, me numer NIPT J64103054Q ,me seli ne Libonik, Vashtemi, Krijuar e vepron ne baze te Vendimit nr 3383 date 05.04.1994 te Gjykates Tirane, rregjistruar ne degen rajonale te taimëve Korce me NIPT J64103054Q, perfaqshuar nga SERVET CENOLLI datlindja 27.11.1950, posedues I Nr Identitetit F01127015I**

Te dy shtetas madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , shpallim si vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar **“OSOJA ENERGY” sh.p.k** me ortake themelues subjektet “ADNAN QYLAFI” Person fizik me TVSh dhe “VASHTMIA” sh.p.k. me gjeneralitet e mesiperme.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themelueseve te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne fshatin Osoje ,Komuna Moglice,Rrethi i Korces,Qarku Korce.. Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e

1.Financimin,Projektimin,ndertimin,venien ne pune, administrimin,mirembajtjen e hidrocentralit **"OSOJA ENERGY"**, dhe transferimin e tij ne perfundim te kontrates nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.Prodhim i energjise elektrike me Burime te Rinovueshme,uje,ere,energji diellore(solare)si dhe transmetimin ,shperndarjen e furnizimin e klienteve te ndryshem. Tregetim i energjise elektrike me Burime te Rinovueshme,uje,ere,energji diellore(solare)si dhe transmetimin ,shperndarjen e furnizimin e klienteve te ndryshem.

Ortaku i shoqerise bie dakort qe aktivitetet e mesiperme do te fillojne pasi shoqeria te pajiset me licencat perkatese.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga 100 kuota me vlefte nominale 1.000 leke secila, me kontributet e ortakeve si me poshte:

1. **"ADNAN QYLAFI"** Person Fizik me TVSH 90.000 leke, 90 kuota ose 90% te kapitalit , numri i votave 90.
2. **"VASHTEMLIA"** sh.p.k. 10.000 leke, 10 kuota ose 10% te kapitalit , numri i votave 10.

Kapitali themeltar do te shlyhet brenda afatit te perfundimit te ndertimit te vepres. Burimi kryesor do te jete kredia bankare qe do merret per kete qellim dhe mjetet e lira te kompanise.

Ndryshimet e kuotave mund te arrihen nepermjet kontributeve ne kapitalin e shoqerise ose me shitblerje.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortaket mund te shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjesisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj.

NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.

- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 11

Administrator i shoqerise "**OSOJA ENERGY**" sh.p.k emerohet z. Adnan Qylafi me afat 5 vjet.

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim te ortakeve, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore.

NENI 14

Ky akt u perpilua ne prani te ortakeve duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire. Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Korce e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

Korce me 27.05.2013

Asambleja e Ortakeve

"Adnan Qylafi"
person fizik me TVSH



"VASHTMIA" sh.p.k.

